

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria -Vlada-Government**

**Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice**

Departamenti për Profesione të Lira-Departmant Slobodnih Profesija- Department of  
Freelance Professions

---

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Comitee

**DPL.nr.52/21**

**KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT**, në përbërje nga Adnan Isufi, kryesues, Diellza Hoxha dhe Rushit Hoxha, anëtarë të komisionit, në çështjen disiplinore ndaj përmbarduesit privat si organ përmbardues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës (tash e tutje Ministria e Drejtësisë) për Territorin e Gjykatës Themelore në i dyshuar për shkelje disiplinore gjatë veprimeve përmbardimore, pas mbajtjes së seancën dëgjimore publike, në të cilën prezantuan përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira-Divizioni për Noterinë dhe Përmbardimin Privat, Znj. Burbuqe Spahija - Kërveshi, në cilësi të iniciuesit të procedurës disiplinore, palës ankuese përmbarduesit privat, si dhe pas seancës këshillimore dhe votimit, me datën 07.12.2021, mori këtë:

**V E N D I M**

- I. **REFUZOHET** raporti përfundimtar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbardimin Privat, DPL-52/2021, datë 01.11.2021, dhe ankesa e palës ankuese, znj. të datës 29.10.2021, si të pa bazuara.
- II. Organi përmbardues-Përmbarduesi Privat, z nuk është përgjegjës për shkelje të pretenduara disiplinore gjatë veprimeve të ndërmarra në lëndën përmbardimore P. nr 180/15.

**A R S Y E T I M**

Me datën 29,10,2021, pala ankuese ka paraqitur ankesë në Ministrinë e Drejtësisë ndaj përmbarduesit privat z. Sipas pretendimeve të palës ankuese, përmbarduesi privat ka bërë shkelje disiplinore të nenit 365, 366 dhe nenit 367 par 1, nën par 1.1, 1.2, dhe 1.4, të Ligjit

për Procedurën Përmbaremore, sepse nuk ka ndërmarr veprime përmbaremore për përmbaremin e Aktgjykimit të plotfuqishëm P. nr 808/14 të datës 18.02.2015, të lëshuar nga Gjykata Themelore në \_\_\_\_\_ – Departamenti i Përgjithshëm, përkundër kërkesës së vazhdueshme të palës për procedim të kësaj lënde.

Me datën 01.11.2021, Ministria e Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbaremin Privat, ka përgatitur Raportin përfundimtar për fillimin e procedurës disiplinore ndaj përmbareusit privat z. \_\_\_\_\_ si organ përmbareues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë për Territorin e Gjykatës Themelore në \_\_\_\_\_, dhe në përputhje me nenin 373 të Ligjit për Procedurën Përmbaremore, ka propozuar që të ndërmerren veprimet e nevojshme lidhur me këtë lëndë.

Përmbareusi privat në përgjigjen e tij me shkrim deklaron që ka vepruar në pajtim me ligjin dhe autorizimet ligjore. Përmbareusi privat z. \_\_\_\_\_ liston veprimet e ndërmarra dhe shton se për shkak të rrethanave objektive përkundër veprime, kjo lëndë nuk ka mundur të përfundohet në tërësi, ndërsa shpenzimet e procedurës përmbaremore dhe shpenzimet e krijuara deri tani nuk i janë ngarkuar kreditorit. Rrjedhimisht, përmbareusit privat z. \_\_\_\_\_ kërkon që të refuzohet ankesa si e pabazuar.

Me datën 07.12.2021, Komisioni ka mbajtur seancë dëgjimore në të cilën kanë marr pjesë përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbaremin Privat, znj. Burbuqe Spahija - Kërveshi, në cilësi të iniciuesit të procedurës disiplinore, pala ankuese znj \_\_\_\_\_ dhe përmbareusi privat, z \_\_\_\_\_ Përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbaremin Privat, Znj. Burbuqe Spahija - Kërveshi, ka bërë shtjellimin e Raportit për fillimin e procedurës disiplinore ndaj përmbareusit privat duke theksuar se mbetet pranë tij. Pala ankuese znj \_\_\_\_\_ ka ngelur pranë ankesës së paraqitur me shkrim si dhe ka bërë eleborimin e saj. Përmbareusi privat z. \_\_\_\_\_ ka paraqitur qëndrimin e tij lidhur me pretendimet e ngritura për shkelje disiplinore.

Në cilësi të provave materiale, Komisioni ka administruar të gjitha provat e bashkangjitura raportit dhe me kujdes, vëmendje të veçantë dhe në mënyrë shteruese ka çmuar çdo provë të administruar në seancën dëgjimore veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe pas analizimit, vlerësimit dhe peshimit të tyre, i njëjti vjen në përfundim se i përmbareusi privat z. \_\_\_\_\_ nuk ka kryer vepër disiplinore.

Komisioni Disiplinor gjen se thelbi i ankesës ndaj përmbareusit privat z. \_\_\_\_\_ janë vonesat e pretenduara në zbatimin e përmbareimit. Nga shkresat e lëndës rrjedh që propozimi për përmbareim ishte paraqitur me dt 29.06.2015. Pas pranimit të propozimit, me dt 02.07.2015, është lejuar përmbareimi. Ndaj urdhrin për përmbareim ishte ushtruar prapësim me dt 14.07.2015, i cili ka rezultuar si i pasafatshëm me aktvendim të gjykatës kompetente. Përmbareusi privat kishte kërkuar informacione për llogaritë bankare të palës debitore nga gjitha bankat komerciale që operojnë në Republikën e Kosovës. Me dt 15.07.2015 kishte nxjerrë urdhrin për bllokimin e llogarive por kishte rezultuar se debitori nuk ka mjete në llogaritë bankare. Përmbareusi privat kishte ndërmarrë veprime për të shikuar mundësinë e lidhjes së palës debitore me një subjekt afarist me dt 11.03.2016, por përsëri edhe ajo llogari kishte rezultuar pasive. Me dt 11.03.2016, përmbareusi

privat ka kërkuar nga Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër në Komunën e ... lidhur me pronat të cilat evidentohen në pronësi të palës debitori por kishte rezultuar se i njëjti nuk ka asnjë pronë në emër të tij. Po ashtu, përmbaruesi privat kishte kërkuar informacione në Agjencinë për Regjistrimin Civil – Departamentin për Regjistrimin e Automjeteve nëse debitori ka në pronësi ndonjë automjet por përsëri nuk ka rezultuar që i njëjti të jetë pronar i ndonjë automjeti. Me dt 10.09.2021, përmbaruesi privat duke parë gatishmërinë edhe të palës kreditore për të dal në terren dhe shkuar në selinë e palës debitore, ka bërë kërkesë në polici për asistencë por Policia e Kosovës kishte refuzuar një kërkesë të tillë për ofrimin e këtij shërbimi për shkak të angazhimeve të tyre tjera.

Duke marr parasysh kompleksitetin e rastit se pala debitore nuk kishte mjete në llogari bankare as pronë në emër të tij, dhe faktorët tjerë objektiv të përshkruar më lartë se përmbaruesi privat nuk kishte të pranuar asistencën nga policia, Komisioni Disiplinor vjen në përfundim se përmbaruesi privat nuk ka kryer shkelje disiplinore. Komisioni gjen se përmbaruesi privat përkundër veprimeve të ndërmarra, ai nuk kishte arritur ta zbatoj atë suksesshëm. Zbatimi i përmbarimit, në rastin konkret, nuk varej ekskluzivisht nga vullneti i përmbaruesit privat. Vonesat në zbatimin e plotë të përmbarimit nuk mund t'i atribuohen përmbaruesit privat. Komisioni nuk gjen se përmbaruesi privat z. Enis Hoxha qëllimisht të ketë ndërmarr veprime që zvarrisin zbatimin e përmbarimit apo të ketë abstenuar në mënyrë të paarsyeshme nga ndërmarrja e veprimeve ligjore për zbatimin e përmbarimit. Përkundrazi, Komisioni Disiplinor gjen se përmbaruesi privat përkundër veprimeve të ndërmarra nuk kishte ngarkuar palën kreditore me asnjë lloj shpenzimi duke ruajtur kështu dinjitetin e saj.

Nga sa u tha më lartë, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


**KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT**  
**DPL.nr 52/2021, datë 07.12.2021**

**Kryesues i Komisionit Disiplinor**  
**Adnan ISUFI**

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrativ bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.

Faint, illegible text, possibly bleed-through from the reverse side of the page.



Faint, illegible text located in the lower-right quadrant of the page.